



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

**01 - Nr. 400-17516/15**  
**Kaçanik, 29.05. 2015**

Mbështetur në nenin 40.2 (b.) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28 e datës 4 qershor 2008), të neneve 20.8, 22 dhe 25 të Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe Ligjit nr.03/L-221. – Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 13 dhe 14 të Ligjit nr.05/L-001.- Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, si dhe nenit 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur më 29 maj 2015, mori këtë:

### **V E N D I M**

### **PËR RISHIKIM TË BUXHETIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2015**

1. Me këtë Vendim Buxheti i Komunës së Kaçanikut për vitin 2015, pas transfereve, ridestinineve dhe harmonizimeve brenda programeve dhe nën-programeve buxhetore do të mbetet i pandryshuar në total **6,858,434 €**.
2. Te Zyra e Kryetarit, buxheti do të zvogëlohet: për **58,320 €** te Shpenzimet Kapitale, për **1,000 €** Mallrat dhe Shërbimet si dhe **308 €** Pagat dhe Mëditjet.
3. Buxheti te Zyra e Kuvendit Komunal do të zvogëlohet për **2,000 €** te Mallrat dhe Shërbimet.
4. Te Administrata dhe Personeli, buxheti do të zvogëlohet në shumë prej **500 €** te Mallrat dhe Shërbimet dhe **1,000 €** te Shpenzimet Komunale.
5. Te programi, Buxheti dhe Financat, buxheti do të zvogëlohet te kategoria ekonomike e Mallrave dhe Shërbimeve në shumë prej **1,000 €**.
6. Te Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile dhe Emergjencia, buxheti do të rritet për **9,500 €** te Mallrat dhe Shërbimet, **17,962 €** do të kemi rritje te Investimet Kapitale dhe zvogëlim te kategoria ekonomike e Shpenzimeve Komunale në shumë prej **6,000 €**.
7. Te Zyra Komunale e Komuniteteve, do të kemi zvogëlim të buxhetit te Mallrat dhe Shërbimet për **500 €**.

8. Buxheti i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të rritet te kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve për **4,000 €**, ndërsa zvogëlim te Investimet Kapitale për **14,359 €**.

9. Te Planifikimi Urban dhe Mjedisi, buxheti do të rritet në shumë prej **34,717 €** në dobi të Shpenzimeve Kapitale dhe rritja e Pagave dhe Mëditjeve prej **308 €** si dhe zvogëlim të Mallrave dhe Shërbimeve prej **1,500 €**.

10. Te Shëndetësia Primare, do të kemi rritje të buxhetit te Shpenzimet Komunale prej **5,000 €**, njëkohësisht këtu do të kemi edhe zvogëlim të buxhetit prej **5,000 €** te Mallrat dhe Shërbimet.

10.1. Gjithashtu te ky program buxhetor do të kemi zvogëlim të buxhetit prej **80 €** te kategoria ekonomike e Pagave dhe rritje po te e njëjta kategori ekonomike te programi i Administratës së Shëndetësisë.

11. Te programi buxhetor, Arsim dhe Shkencë, buxheti do të rritet për **20.000€** të Investimet Kapitale, ndërsa të kategoritë tjera mbesin të pandryshuara, vetëm se ka harmonizime në mes nënprogrameve buxhetore të ky sektor.

12. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë vetëm ndryshimet e bëra në Tabelën 4.1 dhe Tabelën 4.2 të Buxhetit të vitit 2015.

13. Për realizimin e këtij Vendimi, obligohet Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, e cila drejtori të njëjtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe në Departamentin e Thesarit.

14. Ky Vendim pas aprovimit nga Kuvendi i Komunës hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të autoritetit mbikqyrës-MAPL, si dhe pas publikimit në faqën zyrtare të komunës, dhe do të vlejë për deri sa nuk merret ndonjë vendim tjetër.

**Me këtë Vendim të njoftohen:**

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, dhe
3. Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit  
Xhelal Gashi

